

VENDIM
Nr. 191, datë 4.4.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR ETIKETIMIN E ENERGJISË PËR FURRAT SHTËPIAKE DHE ASPIRATORËT THITHËS”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

RREGULL TEKNIK
PËR ETIKETIMIN E ENERGJISË PËR FURRAT SHTËPIAKE DHE ASPIRATORËT THITHËS

1. Objekti dhe fusha e përdorimit

1.1. Ky rregull teknik përcakton kërkesat për etiketimin dhe dhënien e informacionit plotësues për furrat shtëpiake elektrike dhe furrat me gaz (duke i përfshirë edhe kur ato janë të montuara në soba) dhe për aspiratorët thithës elektrikë, duke i përfshirë edhe kur shiten për qëllime joshhtëpiake.

1.2. Ky rregull teknik nuk zbatohet për:

- a) furrat që përdorin burime të energjisë të ndryshme nga ajo elektrike ose gaz;
- b) furra të cilat ofrojnë një funksion ngrohës me mikrovalë;
- c) furrat e vogla;
- ç) furrat e lëvizshme;
- d) furrat me gjenerim të nxehtësisë;
- dh) furrat të cilat nxehen me avull, si një funksion parësor të ngrohjes;
- e) furrat e projektuara për përdorim vetëm me gaze të grupit të tretë (propan dhe butan).

2. Përkufizime

Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, për qëllime të këtij rregulli teknik zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

1. “Furrë” është një pajisje ose pjesë e një pajisjeje, e cila përmban një ose më shumë vende për gatim që përdorin energji elektrike dhe/ose gaz, në të cilat ushqimi përgatitet nga përdorimi i një mënyre konvencionale ose me ventilim të detyruar.

2. “Vend për gatim” është ndarja e mbyllur në të cilën temperatura mund të kontrollohet për përgatitjen e ushqimit.

3. “Furrë me shumë vende për gatim” është një furrë me dy ose më shumë vende për gatim, çdonjëra prej të cilave ngrohet veçmas.

4. “Furrë e vogël” është një furrë ku të gjitha vendet e gatimit kanë një gjerësi dhe thellësi më të vogël se 250 mm ose një lartësi më të vogël se 120 mm.

5. “Furrë e lëvizshme” është një furrë me një peshë më të vogël se 18 kg, e parashikuar që të mos jetë e projektuar për t’u instaluar.

6. “Mikrovalë për ngrohje” është një ngrohëse që përdor energji elektromagnetike për ngrohjen e ushqimeve.

7. “Mënyrë konvencionale” është mënyra e funksionimit të një furre kur përdor vetëm konvencion natyral

¹ Vendimi është në përputhje të plotë me rregulloren e deleguar të komisionit nr. 65/2014, datë 1 tetor 2013, “Për etiketimin e energjisë për furrat shtëpiake dhe aspiratorët thithës”; Nunri CELEX-32014RO0065-EN TXT, “Fletore zyrtare” e Bashkimit Evropian, 29.1.2014, Seria L 29, faqe 1-32.

për qarkullimin e ajrit të nxehtë brenda vendit të gatimit të furrës.

8. “Ventilim i detyruar” është mënyra kur në furrë qarkullon ajër i nxehtë me ventilim brenda vendit të gatimit të furrës.

9. “Cikël” është periudha e ngrohjes e një ngarkese të standardizuar në vendin e gatimit në një furrë, nën kushte të përcaktuara.

10. “Sobë gatimi” është një pajisje e përbërë nga një furrë dhe një vatër që përdor gaz ose energji elektrike.

11. “Mënyra e funksionimit” është statusi i një furre gjatë përdorimit.

12. “Burim nxehtësie” është forma kryesore e energjisë për ngrohjen e një furre.

13. “Aspirator thithës” është një pajisje që funksionon me një motor, i cili e kontrollon atë, i parashikuar të mbledhë ajrin e kontaminuar nga sipër një vatre, ose i cili përfshin një sistem thithës, të parashikuar të instalohet afër me vendet e gatimit, që të tërheqë avujt brenda një kanali të brendshëm.

14. “Mënyrë e funksionimit automatik gjatë periudhës së gatimit” është një kusht në të cilin rryma e ajrit në aspirator, gjatë periudhës së gatimit, është e kontrolluar në mënyrë automatike nëpërmjet sensorit/ve, duke përfshirë lagështinë, temperaturën etj.

15. “Aspirator thithës plotësisht automatik” është një aspirator thithës në të cilin rryma e ajrit dhe/ose funksione të tjera janë automatikisht të kontrolluara nëpërmjet sensorëve gjatë 24 orëve, duke përfshirë dhe periudhën e gatimit.

16. “Pika me eficiencën më të mirë (BEP)” është pika e aspiratorit thithës që operon me eficiencën e rrymës maksimale (FDE hood).

17. “Eficienca e ndriçimit” (LEhood) është raporti ndërmjet ndriçimit mesatar të sistemit të ndriçimit të aspiratorit thithës shtëpiak dhe fuqisë të sistemit të ndriçimit në lux/w.

18. “Eficienca e filtrimit të yndyrave” (GFE hood) është pjesa relative e yndyrave që mbeten brenda filtrave të aspiratorit thithës.

19. “Gjendje e stakuar” është gjendja në të cilën pajisja është e lidhur me burimin e energjisë, por nuk kryen asnjë funksion ose vetëm siguron një tregim të gjendjes në stakim ose siguron vetëm përdorimet e parashikuara për të siguruar përputhshmërinë elektromagnetike, sipas vendimit nr. 1054, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik “Për përputhshmërinë elektromagnetike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara””.

20. “Gjendje e ndezur *standby*” është gjendja në rastin kur pajisja është e lidhur me burimin kryesor të energjisë, varet nga *input*-i i energjisë i burimit kryesor të energjisë që të punojë si është parashikuar dhe siguron vetëm funksionin e riaktivizimit ose funksionin e riaktivizimit dhe vetëm një tregues të funksionit të mundshëm të riaktivizimit dhe/ose informacion, ose shfaqje të statusit se mund të vazhdojë për një kohë të pacaktuar.

21. “Funksion riaktivizimi” është funksioni që lehtëson aktivizimin e mënyrave të tjera, duke përfshirë mënyrën aktive të komandimit nga largësia, duke përfshirë kontrollin nga largësia, sensorë të brendshëm ose kohëmatësin me kushtin që të sigurojë funksione të tjera, duke përfshirë funksionin kryesor.

22. “Informacioni ose statusi i shfaqjes” është funksioni i vazhdueshëm që siguron informacion ose që tregon statusin e pajisjes mbi një ekran, duke përfshirë orën.

23. “Përdorues i fundit” është një konsumator që blen ose parashikon të blejë një produkt;

24. “Pikë shitje” është vendi ku pajisjet ekspozohen dhe/ose ofrohen për shitje ose jepet me qira;

25. “Model i njëjtit” është modeli i vendosur në treg me të njëjtat parametra teknike si një model tjetër i vendosur në treg nga i njëjti prodhues ose importues, me një numër të ndryshëm të kodit tregtar.

3. Etiketa, skeda informative dhe doku-mentacioni teknik

1. Për sa i përket etiketave, skedës informative dhe dokumentacionit teknik, furnizuesi siguron:

a) për furrat shtëpiake:

i. çdo furrë shtëpiake pajiset me etiketë të printuar që përmban për çdo vend gatimi të furrës informacionin si jepet në formatin e nënpikës 1, të pikës 8;

ii. skeda informative e produktit, si jepet në pjesën A, të pikës 9, bëhet e vlefshme për furrat shtëpiake të vendosura në treg;

iii. dokumentacioni teknik, si jepet në pjesën A, të pikës 10, sipas një kërkesë bëhet i vlefshëm për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (më poshtë ISHMT);

iv. një skedë informative elektronike, si jepet në pjesën A, të pikës 9, vihet në dispozicion për shitësit me pakicë për çdo model të furrës shtëpiake.

b) për aspiratorët thithës shtëpiakë:

i. çdo aspirator thithës shtëpiak shoqërohet me një etiketë të printuar që përmban informacionin si jepet në nënpikën 2, të pikës 8;

ii. një skedë informative, si jepet në pjesën B, të pikës 9, vihet në dispozicion për aspiratorin thithës

shtëpiak të vendosur në treg;

iii. dokumentacioni teknik, si jepet në pjesën B, të pikës 10, sipas një kërkesë, vihet në dispozicion të ISHMT-së;

iv. një etiketë elektronike në formatin dhe përmbajtjen e informacionit që jepet në nënpikën 2, të pikës 8, vihet në dispozicion për shitësit me pakicë për çdo model aspiratori thithës shtëpiak;

v. një skedë informative elektronike e produktit, si jepet në pjesën B, të pikës 9, vihet në dispozicion për shitësit me pakicë për çdo model të aspiratorit thithës shtëpiak.

2. Lidhur me klasat e eficiencës:

a) për furrat shtëpiake, klasa e eficiencës së energjisë për vendin e gatimit të furrës përcaktohet në përputhje me nënpikën 1, të pikës 7 dhe nënpikën 1, të pikës 5;

b) për aspiratorët thithës shtëpiakë:

i. klasat e eficiencës së energjisë përcaktohen në përputhje me nënpikën 2(a), të pikës 7 dhe nënpikën 2.1, të pikës 5;

ii. klasat e eficiencës së rrjedhës dinamike përcaktohen në përputhje me nënpikën 2(b), të pikës 7, dhe nënpikën 2.2, të pikës 5;

iii. klasat e eficiencës së ndriçimit përcaktohen në përputhje me nënpikën 2(c), të pikës 7 dhe nënpikën 2.3, të pikës 5;

iv. klasat e eficiencës së filtrimit të yndyrave përcaktohen në përputhje me nënpikën 2(d), të pikës 7, dhe nënpikën 2.4, të pikës 5.

3. Për sa i përket formatit të etiketave:

a) Për furrat shtëpiake, formati i etiketës për vendin e gatimit të furrës jepet sipas pikës 1, të pikës 8;

b) Për aspiratorët thithës shtëpiakë, formati i etiketës jepet sipas nënpikës 2, të pikës 8, sipas afateve kohore të mëposhtme:

i. për aspiratorët thithës shtëpiakë, të vendosur në treg me klasat e eficiencës së energjisë A, B, C, D, E, F dhe G, etiketat jepen në përputhje me nënpikën 2.1.1, në pikën 8 (Etiketa 1) ose kur furnizuesit e gjykojnë të përshtatshme, me nënpikën 2.1.2, të kësaj pike (Etiketa 2);

ii. për aspiratorët thithës shtëpiakë, të vendosur në treg me klasat e eficiencës së energjisë A+, A, B, C, D, E dhe F, etiketat jepen në përputhje me nënpikën 2.1.2, të pikës 8 (Etiketa 2) ose kur furnizuesit e gjykojnë të përshtatshme, me nënpikën 2.1.3, të kësaj pike (Etiketa 3);

iii. për aspiratorët thithës shtëpiakë, të vendosur në treg pas 1 janarit 2018, me klasa të eficiencës së energjisë A++, A+, A, B, C, D dhe E, etiketat duhet të jenë në përputhje me nënpikën 2.1.3, të pikës 8 (Etiketa 3) ose kur furnizuesi e gjykon të përshtatshme, me nënpikën 2.1.4, të kësaj pike (Etiketa 4);

iv. për aspiratorët thithës shtëpiakë, të vendosur në treg pas datës 1 janar 2020, me klasa të eficiencës së energjisë A+++, A++, A+, A, B, C dhe D, etiketat duhet të jenë në përputhje me nënpikën 2.1.4, të pikës 8 (Etiketa 4).

4. Shitësit me pakicë sigurojnë që:

a) Për furrat shtëpiake:

i. çdo furrë shtëpiake, e paraqitur në pikën e shitjes, çdo vend për gatim të parashikuar nga furnizuesi, mban etiketën në përputhje me pikën 3.1a) (i), të vendosur në pjesën e përparme ose të sipërme të pajisjes, në atë mënyrë që të jetë qartësisht e dukshme dhe e identifikueshme si etiketë që i përket modelit, pa pasur nevojë të lexohet emri i markës dhe numri i modelit në etiketë;

ii. furrat e ofruara për shitje ose me qira, në rastin kur përdoruesi i fundit nuk mund të shikojë produktin e shfaqur, si të specifikuar në nenin 6.2, të ligjit nr. 68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, tregtohen me informacionin e dhënë nga furnizuesi në përputhje me pjesën A, të pikës 11, të këtij rregulli teknik, përveç rastit kur oferta bëhet përmes internetit, dhe në këtë rast zbatohen dispozitat e pikës 12.

5. Për aspiratorët thithës shtëpiakë:

a) çdo aspirator thithës shtëpiak, i paraqitur në pikën e shitjes, shoqërohet me etiketën e siguar nga furnizuesit në përputhje me pikën 3.1 b)(i), e vendosur në pjesën e përparme ose të sipërme të pajisjes, në atë mënyrë që të jetë qartësisht e dukshme dhe e identifikueshme si etiketë që i përket modelit, pa pasur nevojë të lexohet emri i markës dhe numri i modelit në etiketë;

b) aspiratorët thithës shtëpiakë, të ofruar për shitje ose me qira, në rastin kur përdoruesi i fundit nuk mund të shikojë produktin e shfaqur, si të specifikuar në nenin 6.2, të ligjit nr. 68/2012, “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”, tregtohen me informacionin e dhënë nga furnizuesi në përputhje me pjesën B, të pikës 11, të këtij rregulli teknik, përveç rastit kur oferta bëhet përmes internetit, dhe në këtë rast zbatohen dispozitat e pikës 12.

4. Përmbajtja e etiketës në rastin e publicitetit

1. Furnizuesit që vendosin në treg furra shtëpiake dhe aspiratorë thithës shtëpiakë sigurojnë që:
 - a) çdo publicitet për një model të veçantë të furrës shtëpiake përmban klasat e eficiencës së energjisë, nëse publiciteti përmban informacion të lidhur me energjinë ose çmimin;
 - b) çdo material teknik publiciteti që përmban një model të veçantë të një furre elektrike përfshin klasën e eficiencës së atij modeli kur përshkruan parametrat teknikë të veçantë të tij;
 - c) çdo publicitet për një model specifik të një aspiratori thithës shtëpiak përmban klasën e eficiencës së energjisë, nëse publiciteti përmban informacion të lidhur me energjinë ose çmimin;
 - ç) çdo material teknik publiciteti që përmban një model të veçantë të një aspiratori thithës shtëpiak, përfshin klasën e eficiencës së atij modeli nëse përshkruan parametrat teknikë të veçantë të tij.

2. Shitësit me pakicë sigurojnë që:

- a) çdo publicitet, për çdo formë ose shitje në distancë dhe tregtim, për sa i përket një modeli të veçantë të furrës, përmban një referim të klasës së eficiencës së energjisë, nëse publiciteti përmban informacion të lidhur me energjinë ose çmimin;
- b) çdo material teknik publiciteti që përmban një model të veçantë përfshin klasën e eficiencës së energjisë të modelit nëse përshkruan parametrat teknikë të një furre;
- c) çdo material teknik publiciteti që përmban një model të veçantë, përfshin klasën e eficiencës së energjisë së modelit nëse përshkruan parametrat teknikë të një aspiratori thithës shtëpiak;
- ç) çdo material teknik publiciteti që përmban një model të veçantë, përfshin klasën e eficiencës së energjisë së modelit nëse përshkruan parametrat teknikë të një aspiratori thithës shtëpiak.

5. Matjet dhe metodat e llogaritjes

Informacioni i dhënë në pikat 3 dhe 4 duhet të sigurohet përmes procedurave të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme të matjeve, të cilat marrin parasysh metodat e njohura më të avancuara të metodave të llogaritjes dhe të matjes.

Për qëllime të përputhjes dhe të verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e këtij rregulli teknik, matjet dhe llogaritjet të bëhen duke përdorur një metodë të besueshme, të saktë dhe të riprodhueshme, që merr parasysh teknologjinë përgjithësisht të pranuar të metodave të matjes dhe të llogaritjeve, duke përfshirë standardet e harmonizuara. Ato duhet të plotësojnë përcaktimet teknike, kushtet, formulat dhe parametrat e dhëna në këtë pikë.

1. Furrat shtëpiake

Konsumi i energjisë i një vendi të gatimit në një furër shtëpiake matet për një cikël të standardizuar, në mënyrën konvencionale dhe në mënyrën e detyruar me ventilim, nëse është e mundur, me ngrohjen e një ngarkese të standardizuar të zhytur në ujë. Ajo verifikon se temperatura brenda vendit të gatimit në furër arrin temperaturën e termostatit dhe/ose në ekranin e kontrollit të furrës brenda kohëzgjatjes së ciklit të testit. Konsumi i energjisë për cikël që i korrespondon mënyrës më të mirë të performimit (mënyra konvencionale ose mënyra e detyruar me ventilim) duhet të përdoret në llogaritjet e mëposhtme. Për çdo ndarje të një furre shtëpiake, Indeksi i Eficiencës së Energjisë (EEI cavity) llogaritet sipas formulave të mëposhtme:

Për furrat elektrike shtëpiake

$$EEI_{cavity} = \frac{EC_{electric\ cavity}}{SEC_{electric\ cavity}} \times 100$$

$$SEC_{electric\ cavity} = 0,0042 \times V + 0,55$$

(në kwh)

për furrat shtëpiake me gaz:

$$EEI_{cavity} = \frac{EC_{gas\ cavity}}{SEC_{gas\ cavity}} \times 100$$

$$SEC_{gas\ cavity} = 0,044 \times V + 3,53$$

(në MJ)

ku:

- EEI cavity = Indeksi i Eficiencës së Energjisë për çdo vend gatimi në një furër shtëpiake në %, i rrumbullakosur pas presjes së parë dhjetore;

- SEC electric cavity = Konsumi Standard i Energjisë, i kërkuar për ngrohjen e një ngarkese të standardizuar në një vend gatimi të një furre elektrike shtëpiake gjatë një cikli, i shprehur në kwh, i rrumbullakosur pas një presje dhjetore;

- SEC gas cavity = Konsumi Standard i Energjisë, i kërkuar për të ngrohur një ngarkesë të

standardizuar në një vend gatimi të një furre shtëpiake me gaz gjatë një cikli, i shprehur në MJ, i rrumbullakosur në presjen e dytë dhjetore;

-V = Volumi i një vendi gatimi të një furre shtëpiake në litra (L), i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

- EC electric cavity = Konsumi i kërkuar për të ngrohur një ngarkesë të standardizuar në një vend gatimi të një furre elektrike shtëpiake gjatë një cikli, i shprehur në kwh, i rrumbullakosur në presjen e dytë dhjetore;

- EC gas cavity = Konsumi i energjisë i kërkuar për të ngrohur një ngarkesë të standardizuar në një vend gatimi të një furre me gaz gjatë një cikli, i shprehur në MJ, i rrumbullakosur në presjen e dytë dhjetore.

2. Aspiratorët thithës shtëpiake

2.1 Llogaritja e Indeksit të Eficiencës së Energjisë (EEI hod)

Indeksi i Eficiencës së Energjisë (EEI hod) llogaritet si:

$$EEI_{hood} = \frac{AEC_{hood}}{SAEC_{hood}} \times 100$$

dhe i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore,

ku:

- SAEC hood është konsumi standard vjetor i energjisë së aspiratorit shtëpiake në kwh/vit, i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore;

- AEC hod është konsumi vjetor i energjisë i aspiratorit shtëpiake në kwh/vit, i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore.

Konsumi Standard vjetor i Energjisë ($SAEC_{hood}$) i një aspiratori shtëpiake llogaritet si:

$$SAEC_{hood} = 0,55 \times (W_{BEP} + W_L) + 15,3$$

ku:

- WBEP është *input*-i i fuqisë elektrike i aspiratorit shtëpiake në pikën më të mirë të eficiencës në watt dhe i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore;

- WL është *input*-i nominal i fuqisë elektrike i sistemit të ndriçimit i aspiratorit shtëpiake mbi sipërfaqen e gatimit, në watt, i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore;

Konsumi vjetor i energjisë (AEC hot) i një aspiratori shtëpiake llogaritet si:

Për aspiratorin plotësisht automatik

$$AEC_{hood} = \left[\frac{(W_{BEP} \times t_H \times f) + (W_L \times t_L)}{60 \times 1000} + \frac{P_o \times (1440 - t_H \times f)}{2 \times 60 \times 1000} + \frac{P_s \times (1440 - t_H \times f)}{2 \times 60 \times 1000} \right] \times 3$$

Për të gjithë aspiratorët e tjerë:

$$AEC_{hood} = \frac{[W_{BEP} \times (t_H \times f) + W_L \times t_L]}{60 \times 1000} \times 365$$

ku

- t_L është kohë mesatare e ndriçimit në ditë, në minutat ($t_L = 120$);

- t_H është kohë mesatare punuese ditore për aspiratorin shtëpiake, në minuta ($t_H = 60$);

- P_o është *input*-i i fuqisë elektrike në gjendje të stakuar (*off mode*) i aspiratorit shtëpiake në watt, i rrumbullakosur në presjen e dytë dhjetore;

- P_s është *input*-i i fuqisë elektrike në gjendje të ndezur (*standby*) i aspiratorit, në watt, i rrumbullakosur në presjen e dytë dhjetore;

- f është faktori i rritjes së kohës, i llogaritur dhe i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore, si

$$f = 2 - (FDE_{hood} \times 3,6)/100$$

2.2 Llogaritja e eficiencës së rrjedhës dinamike (FDE hood). Eficiencia e rrjedhës dinamike në pikën më të mirë të eficiencës llogaritet me formulën e mëposhtme dhe e rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore:

$$FDE_{hood} = \frac{Q_{BEP} \times P_{BEP}}{3600 \times W_{BEP}} \times 100$$

ku:

- Q_{BEP} është rrjedha në pikën më të mirë të eficiencës, e shprehur në m^3 /orë dhe e rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore;

- P_{BEP} është diferenca e presionit statik në pikën më të mirë të eficiencës, e shprehur në Pa dhe e rrumbullakosur në numrin më të afërt;

- WBEP është *input*-i i energjisë elektrike në pikën më të mirë të eficiencës, i shprehur në watt dhe i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore.

2.3 Llogaritja e Eficiencës së Ndrëçimit (LE_{hood})

Eficienca e Ndrëçimit (LE_{hood}) e aspiratorit shtëpiak është raporti ndërmjet ndrëçimit mesatar dhe *input*-it nominal të fuqisë elektrike të sistemit të ndrëçimit. Ajo llogaritet në lux për wat, e rrumbullakosur në numrin më të afërt, si

$$LE_{hood} = \frac{E_{middle}}{W_L}$$

ku:

E middle është ndrëçimi mesatar i sistemit të ndrëçimit mbi sipërfaqen gatuese, i matur nën kushte standarde, në lux dhe i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt,

- W_L është *input*-i nominal i energjisë elektrike të sistemit të ndrëçimit të aspiratorit mbi sipërfaqen gatuese, në wat dhe i rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore.

2.4 Llogaritja e eficiencës së filtrimit të yndyrave (GFE_{hood})

Eficienca e filtrimit të yndyrave (GFE_{hood}) e një aspiratori shtëpiak është llogaritja relative e yndyrës e mbajtur në filtrat e aspiratorit. Ajo llogaritet me formulën e mëposhtme dhe rrumbullakoset në presjen e parë dhjetore;

$$GFE_{hood} = [w_g / (w_r + w_t + w_g)] \times 100 \text{ [%]}$$

ku:

- w_g = masa e vajit në filtrin e yndyrës, duke përfshirë të gjitha mbulesat e ndashme në g dhe e rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore;

- w_r = masa e vajit e mbajtur në ajër e aspiratorit në g dhe e rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore;

- w_t = masa e vajit e mbajtur në filtër në g dhe e rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore.

2.5 Zhurma

Vlera e zhurmë (në dB) matet si zhurmë akustike në ajër A ponderuar e fuqisë së tingullit (vlera mesatare e ponderuar – LWA) e një aspiratori shtëpiak në përdorimin e tij maksimal, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

6. Procedura e verifikimit për qëllime të mbikëqyrjes së tregut nga ISHMT-ja

Për qëllime të vlerësimit të konformitetit të produkteve me kërkesat e dhëna në këtë rregull teknik, ISHMT-ja zbaton procedurën e mëposhtme:

1. ISHMT-ja teston një njësi të vetme produkti.

2. Modeli konsiderohet se përmbush kërkesat e zbatuara nëse:

a) vlerat dhe klasat në etiketë dhe në skedën informative të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin se vlerat në dokumentacionin teknik, duke përfshirë raportet e testimit; dhe

b) testimi i parametrave të modelit përkatës, duke zbatuar tolerancat e listuara në tabelën 6, tregon përputhjen me të gjithë këta parametra.

3. Nëse rezultati i referuar në pikën 2a), të kësaj pike, nuk është arritur, modeli dhe të gjitha modelet e njëvlershme konsiderohen se nuk janë në përputhje me këtë rregull teknik.

4. Nëse rezultati i referuar në nënpikën 2b), të kësaj pike, nuk është arritur, ISHMT-ja duhet të selektojë për testim tri njësi shtesë të së njëjtit model.

Si një alternativë, tri njësitë shtesë të selektuara mund të jenë nga një ose më shumë modele të cilat kanë qenë të listuara si produkt i njëvlershëm në dokumentacionin teknik të furnizuesit.

5. Modeli konsiderohet se përmbush kërkesat e zbatuara nëse testimi i parametrave të modelit përkatës, të listuar në tabelën 6, tregon përputhjen me të gjithë këta parametra.

6. Nëse rezultati i referuar në nënpikën 5, të kësaj pike, nuk është arritur, modeli dhe të gjitha modelet e njëvlershme konsiderohen se nuk përputhen me këtë rregull teknik. ISHMT-ja duhet të sigurojë rezultatet e testimit dhe informacionin përkatës për ministrinë për tregtinë, brenda një muaji pas marrjes së vendimit mbi mospërputhshmërinë e modelit.

ISHPM-ja duhet të përdorë metodat e matjes dhe të llogaritjeve të dhëna në pikën 5.

Tolerancat e dhëna në këtë pikë zbatohen vetëm në verifikimin e parametrave të matur, duke paraqitur variantet e lejuara të rezultateve të matjes të verifikimit të testeve dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesit në krijimin e vlerave në dokumentacionin teknik ose në interpretimin e këtyre vlerave, me qëllim që të arrihet një klasifikim më i mirë i etiketimit ose për të komunikuar performancën më të mirë në çdo kuptim.

Tabela 6
Tolerancat e verifikimit

Parametrat e matur	Tolerancat e verifikimit
Masa e furrës (M)	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të M jo më shumë se 5 %.
Volumi i ndarjes së gatimit të furrës (V)	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e deklaruar e V jo më shumë se 5 %.
EC electric cavity EC gas cavity	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar EC electric cavity, EC gas cavity jo më shumë se 5 %.
W BEP, W L	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar të W BEP dhe W L jo më shumë se 5 %.
Q BEP, P BEP	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar e Q BEP, P BEP jo më shumë se 5 %.
Q max	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar jo më shumë se 8%.
E middle	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar 5%.
GFE hood	Vlera e përcaktuar nuk duhet të jetë më e ulët se vlera e deklaruar GFE hood jo më shumë se 5%.
Po, Ps	Vlera e përcaktuar e konsumit të fuqisë <i>Po</i> and <i>Ps</i> nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar jo më shumë se 10%. Vlera e përcaktuar e konsumit të energjisë <i>Po</i> and <i>Ps</i> me më pak ose e barabartë me 1,00 w nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar jo më shumë se 0.10 w
Niveli i fuqisë së zhurmës L wA	Vlera e përcaktuar nuk duhet të kalojë vlerën e deklaruar.

7. Klasat e eficiencës

1. Furrat për përdorim shtëpiak

Klasat e eficiencës së energjisë e furrave për përdorim shtëpiak përcaktohen të ndara për çdo vend për gatim, në përputhje me vlerat e dhëna në tabelën 1, të kësaj pike.

Efienca e energjisë për furrat përcaktohet në përputhje me nënpikën 1, të pikës 5.

Tabela 1
Klasat e eficiencës së energjisë e furrave për përdorim shtëpiak

Klasa e eficiencës	Eficienca e energjisë Indeksi (EEI cavity)
A+++ (më shumë eficiente)	EEI cavity < 45
A++	$45 \leq \text{EEI cavity} < 62$
A+	$62 \leq \text{EEI cavity} < 82$
A	$82 \leq \text{EEI cavity} < 107$
B	$107 \leq \text{EEI cavity} < 132$
C	$132 \leq \text{EEI cavity} < 159$
D	Më pak eficiente) $\text{EEI cavity} \geq 159$

2. Aspiratorët thithës për përdorim shtëpiak

a) Klasat e eficiencës së energjisë së aspiratorëve thithës për përdorim shtëpiak përcaktohen në përputhje me vlerat e dhëna në tabelën 2, të kësaj pike. Indeksi (EEI hood) i aspiratorëve thithës shtëpiakë llogaritet në përputhje me nënpikën 2.1, të pikës 5.

Tabela 2
Klasat e eficiencës së energjisë të aspiratorëve thithës shtëpiakë

Klasa e eficiencës së energjisë	Indeksi i energjisë (EEI_{hood})			
	Etiketa 1	Etiketa 2	Etiketa 3	Etiketa 4
A+++ (më shumë eficiente)				$EEI_{hood} < 30$
A++			$EEI_{hood} < 37$	$30 \leq EEI_{hood} < 37$
A+		$EEI_{hood} < 45$	$37 \leq EEI_{hood} < 45$	$37 \leq EEI_{hood} < 45$
A	$EEI_{hood} < 55$	$45 \leq EEI_{hood} < 55$	$45 \leq EEI_{hood} < 55$	$45 \leq EEI_{hood} < 55$
B	$55 \leq EEI_{hood} < 70$	$55 \leq EEI_{hood} < 70$	$55 \leq EEI_{hood} < 70$	$55 \leq EEI_{hood} < 70$
C	$70 \leq EEI_{hood} < 85$	$70 \leq EEI_{hood} < 85$	$70 \leq EEI_{hood} < 85$	$70 \leq EEI_{hood} < 85$
D	$85 \leq EEI_{hood} < 100$	$85 \leq EEI_{hood} < 100$	$85 \leq EEI_{hood} < 100$	$EEI_{hood} \geq 85$
E	$100 \leq EEI_{hood} < 110$	$100 \leq EEI_{hood} < 110$	$EEI_{hood} \geq 100$	
F	$110 \leq EEI_{hood} < 120$	$EEI_{hood} \geq 110$		
G (më pak eficiente)	$EEI_{hood} \geq 120$			

b) Klasat e eficiencës së energjisë të rrjedhës dinamike të aspiratorit shtëpiak përcaktohen në përputhje me eficiencën e rrjedhës dinamike (FDE_{hood}), të dhëna në tabelën 3, të mëposhtme. Eficienca e rrjedhës dinamike e aspiratorit përcaktohet në përputhje me nënpikën 2.2, të pikës 5.

Tabela 3
Klasat e eficiencës të rrjedhës dinamike për aspiratorët shtëpiakë

Klasa e eficiencës së rrjedhës dinamike	Eficienca (FDE_{hood}) e rrjedhës dinamike
A (më shumë eficiente)	$FDE_{hood} > 28$
B	$23 < FDE_{hood} \leq 28$
C	$18 < FDE_{hood} \leq 23$
D	$13 < FDE_{hood} \leq 18$
E	$8 < FDE_{hood} \leq 13$
F	$4 < FDE_{hood} \leq 8$
G (më pak eficiente)	$FDE_{hood} \leq 4$

c) Klasat e eficiencës së ndriçimit të një aspiratori thithës shtëpiak përcaktohen në përputhje me eficiencën e ndriçimit (LE_{hood}), të dhëna në tabelën 4, të mëposhtme. Eficienca e ndriçimit e aspiratorit thithës shtëpiak përcaktohet në përputhje me nënpikën 2.3, të pikës 5.

Tabela 4
Klasat e eficiencës së ndriçimit për aspiratorin thithës shtëpiak

Klasa e eficiencës së ndriçimit	Eficienca e ndriçimit (LE_{hood})
A (më shumë eficiente)	$LE_{hood} > 28$
B	$20 < LE_{hood} \leq 28$
C	$16 < LE_{hood} \leq 20$
D	$12 < LE_{hood} \leq 16$
E	$8 < LE_{hood} \leq 12$
F	$4 < LE_{hood} \leq 8$

G (më pak eficiente)	$LE_{hood} \leq 4$
----------------------	--------------------

ç) Klasat e eficientës e filtrimit të yndyrave në një aspirator thithës shtëpiak përcaktohen në përputhje me eficientën e filtrimit të yndyrave, të dhëna në tabelën 5, të mëposhtme. Eficienca e filtrimit të yndyrave e aspiratorëve thithës shtëpiakë përcaktohet në përputhje me nënpikën 2.4, të pikës 5.

Tabela 5

Klasat e eficientës së filtrimit të yndyrave (GFE_{hood}) për aspiratorë thithës shtëpiakë


Klasa e eficientës e filtrimit të yndyrave	Eficienca e filtrimit të yndyrave (%)
A (më shumë eficiente)	$GFE_{hood} > 95$
B	$85 < GFE_{hood} \leq 95$
C	$75 < GFE_{hood} \leq 85$
D	$65 < GFE_{hood} \leq 75$
E	$55 < GFE_{hood} \leq 65$
F	$45 < GFE_{hood} \leq 55$
G (më pak eficiente)	$GFE_{hood} \leq 45$

8. Etiketa

1. Etiketa për furrat shtëpiake

1.1 Furrat elektrike shtëpiake

1.1.1 Paraqitja e etiketës – për çdo ndarje të një furre elektrike shtëpiake



1.1.2 Informacioni në etiketë – furrat elektrike shtëpiake


Në etiketë duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Emri ose marka tregtare e furnizuesit;
- Identifikimi i modelit të furnizuesit, që nënkupton kodin, zakonisht alfanumerik, i cili dallon një model të veçantë të furrës shtëpiake nga modelet e tjera me të njëjtën markë tregtare ose emër të furnizuesit;
- Burimi i energjisë së furrës shtëpiake;
- Klasa e eficientës së energjisë së ndarjes, përcaktuar në përputhje me pikën 7. Maja e shigjetës që përmban shkronjën treguese vendoset në të njëjtin drejtim me majën e shigjetës të klasës përkatëse të eficientës së energjisë;
- Volumi i përdorur i ndarjes në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
- Konsumi i energjisë për cikël, i shprehur në kwh/cikël (konsumi i energjisë) për funksion/e

ngrohës/e (konvencional dhe nëse i vlefshëm për konveksionin me ventilim me rrymë) të ndarjes, të bazuar mbi ngarkesë standarde, të përcaktuar në përputhje me procedurat e testimit, të rrumbullakosura në presjen e dytë dhjetore (EC elektrik cavity).

1.1.3 Modeli i etiketës – furra elektrike shtëpiake

Modeli i etiketës për çdo ndarje të një furre elektrike shtëpiake duhet të jetë si në figurën e mëposhtme:



ku:

